

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada - Government

***Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural
Development***

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe nenin 38, të Ligjit Nr.2004/21 për Veterinarinë të datës 30.07.2004 Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Nxjerr sa vijon :

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 21/2008
Për përcaktimin e procedurave për pranimin e mostrave për analiza

Neni 1
Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve dhe me qëllim të organizimit më efikas të punës në Laboratorin e Veterinarisë dhe të Ushqimit të Republikës së Kosovës, përcaktohen mënyrat dhe procedurat e pranimit, evidentimit të mostrave si dhe të leshuarjes së rezultateve të analizave laboratorike të cilat kryhen në Laboratorin e Veterinarisë dhe të Ushqimit.

Neni 2

Mostrat - materiali për analiza mund të jete si:

- a) mostër zyrtare nënkupton çdo mostër që sillet nga zyrtari i Agjencisë së Veterinarisë dhe të Ushqimit Kosovës - AVUK për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit;
- b) mostër për vetëkontroll nga subjektet, fabrikat e aprovuara nga AVUK qumështoret, thertoret për implementim të sistemeve të ndryshme ISO, HACCP;
- c) mostër e programit nacional qeveritar në bazë të udhëzimeve administrative të Agjencionit të Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës për kontrollin e sëmundjeve zoonotike të kafshëve;
- d) mostra për hulumtime shkencore-projekte vendore ose bashkëpunime – pjesëmarrje në projekte te ndryshme;
- e) mostër për diagnostifikim të sëmundjeve e sjellë nga veterinerët e aprovuar nga AVUK-së;
- f) mostër për validim certifikim dhe akreditim me ISO 17025 të LVUK-se

Neni 3

Fletë përcjellja e secilës mostër për dorëzim në laborator, duhet të ketë këto të dhëna;

1. data e marrjes së mostrës;
2. lloji i mostrës - materialit për analiza;
3. lloji i kafshës;
4. numri i protokollit;
5. të dhënat për atë që e merr mostrën - personi - subjekti Nr. i Licencës;
6. të dhënat për pronarin - emri, mbiemri, adresa telefoni, organizata;
7. të dhënat për kafshën-lloji, gjinia, raca, mosha, ID;
8. përshkrimi i mostrës -materialit - evidentimi i saj dhe data;
9. cilat analiza kërkohen;
10. dyshimi në sëmundje apo grup sëmundjesh;
11. data e ngordhjes ose therjes;
12. ndryshimet pato-anatomike -nëse është kryer Nekropsia;
13. gjendja epizootologjike - numri i kafshëve të prekura të kafshëve apo njerëzve, vaksinimet e kafshëve dhe nga cilat sëmundje;
14. të dhënat për shërbimet e kryera,
15. të dhënat për dërguesin e mostrës i cili e dërgon mostrën ne ekzaminim - personi – subjekti;
16. të shënohet në kuti përmbajtja - për manipulim gjatë transportit dhe në laborator nëse nuk bëhet më anë të kuririt;
17. peshqit dërgohen kryesisht përmes kuririt ose zyrtarit veterinar te autoritetit kompetent;
18. një kopje e fletë përcjellëses vendoset në pako dhe për shkak të mundësisë së dëmtimit të saj një kopje dërgohet ndaras nga pakoja.

Neni 4

Mostra duhet të dorëzohet si mostër reprezentative me ç'rast duhet pas parasysh:

- a) zgjedhjen e drejtë të mostrës-sëmundja që dyshohet, sasia;
- b) freskinë e mostrës;
- c) mënyrën e marrjes – sterile;
- d) paketimin-ambalazhin;
- e) mënyrën e dërgimit - transportit në analiza - frigorifer mobil.

Neni 5

Pranimi i mostrës bëhet në Laboratorin e Veterinarisë dhe Ushqimit nga personeli teknik, me ç'rast plotësohet forma "Pranimi i Mostrave LVUK /M -1", duke pasur kujdes, në përputhshmërinë e mostrës me fletëdërgesën e klientit. Mostra regjistrohet me numër identifikues.

Neni 6

Në rast se mostra nuk ka fletë përcjellëse, atëherë personeli teknik e plotëson formën gjenerale të „Forma e përgjithshme LVUK / M -7 ” nga informatat e klientit.

Neni 7

Nëse mostrimin e ka kryer zyrtari nga laboratori, atëherë ai në pranim, plotëson formën, "Të mostruarit LVUK/M-5".

Neni 8

Formulari i pranimi të mostrës në laborator përbëhet nga katër kopje: e para i jepet klientit, e dyta i jepet laboratorit përkatës për analiza të caktuara, e treta mbetet në dokumentet e pranimi dhe e katërta dërgohet në arkiv.

Neni 9

Pas pranimi të mostrës, e njëjta dërgohet për analiza që duhet të kryhen sipas formës "Urdhri i Analizave Laboratorike LVUK/M-3" bashkëngjitur me formën e "Pranimi të mostrës LVUK/M-1".

Neni 10

Mostra, varësisht se në cilin laborator dërgohet, evidentohet në librat e protokollit sipas kërkesave dhe llojit të analizave që kërkohen të kryhen.

Neni 11

Në rast se mostra arrin me postë, zbatohet e njëjta procedurë e evidentimit dhe plotësimit të Formës se përgjithshme LVUK/M-7, por dërguesi, duhet të njoftohet për arritjen e saj.

Neni 12

Mostra e papërshtatshme për analiza refuzohet nga pranuesi i mostrës me anë të formës LVUK/M-2, ndërsa mostra që vjen në laborator pa flete dërgesë ose me mangësi tjetër, evidentohet si "mostër në pritje forma LVUK/M-4", e cila nëse nuk kompletohet në afat prej katër (4) ditësh asgjësohet si e papërshtatshme për analiza.

Neni 13

Mostrat që nuk mund të kryhen ose analizohen në LVUK, dërgohen në laborator tjerë ose, dërgohen për konfirmim në Laborator Referent-RL ose Laboratorë Referente të Komunitetit -CRL sipas formës LVUK/M-6.

Neni 14

Për çështje teknike në lidhje me marrjen e mostrave, sasinë, llojin, paketimin, ruajtjen, transportin e çështje të tjera do të veprohet sipas Doracakut të LVUK-se, sipas Procedurave Operative Standarde- POS.

Neni 15

15.1 Për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ Kryeshefi Ekzekutiv i AVUK-së me propozimin e Drejtorit të LVUK-së nxjerr vendime të posaçme.

15.2 Pjesë përbërëse të këtij udhëzimi administrativ janë format e formularëve të bashkëngjitura.

Neni 16

Hyrja në fuqi


Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë 31.03 2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Ministri,

Idriz Vehapi



FORMAT E PRANIMIT TE MOSTRAVE NE LVUK;

1. Pranimi i Mostrave	LVUK / M -1
2. Refuzimi i Mostrave	LVUK / M -2
3. Urdhri i Analizave Laboratorike	LVUK / M -3
4. Mostrat ne Pritje	LVUK / M -4
5. Te Mostruarit	LVUK / M -5
6. Dërgimi i Mostrave ne Laboratorë tjera –Referente	LVUK / M -6
7. Forma e Përgjithshme – Recepcion.	LVUK / M -7

1. PRANIMI I MOSTRAVE –LVUK / M-1

TE DHENAT E KLIENTIT			
Nr. Identifikues i mostrës (ID_M)			
Emri i klientit, organizata			
Adresa/Rruga			
Vendi/Fshati dhe nr. postal			
Regjioni			
Nr. i licencës			
Telefoni			
Telefax			
E-mail			
Te dhënat për mostrën			
Data e dërgimit të mostrës:			
Lloji i mostrës:			
Marruar me datën:		Ora:	
Emri i mostruesit, subjekti ku punon:			
Emri i personit që e dorëzoi mostrën:			
Paketimi:		Sasia:	
Temperatura e ruajtjes (sipas nevojës):	< 0°C	0 °C - 10 °C	>10 °C
Vendi i ruajtjes:	Frigo	Frigorifer	Temperatura e dhomës
Mostra është dorëzuar me qëllim:			
Diagnostifikimi ose analizë hulumtuese			
Program qeveritar në bazë të ligjit (karantinë, monitorim)			
Hulumtime			
TE DHENAT PER MENYREN E PAGESES			
Pagesa sipas kontratës nr.:		Pagesa sipas çmimore:	
Banka komitent :		Pagesa sipas:	
Klienti është i pranishëm gjatë kryerjes së analizës:		PO	JO
Data:		Ora:	
Nënshkrimi i drejtorit të Laboratorit që ka miratuar praninë e klientit:			
Me përfundimin e analizave laboratorike, mostra asgjësohet nëse klienti nuk e kërkon ndryshe. Lloji i analizave që do të kryhen është i cekur në formën nr. 3. Përgjegjësinë për mostrim dhe dërgimin e mostrës në laborator e merr klienti.			
Mostrën e dorëzoi:		Mostrën e pranoi:	

2. REFUZIMI I MOSTRAVE LVUK / M-2

TE DHENAT E KLIENTIT	
Nr. Identifikues i mostrës (ID_M)	
Emri i klientit, organizata	
Adresa/Rruga	
Vendi/Fshati dhe nr. postal	
Regjioni	
Nr. i licencës	
Telefoni	
Telefax	
E-mail	
Te dhënat për marrjen e mostrës	
Data dhe ora e marrjes se mostrës	
Vendi (adresa) e marrjes se mostrës	
Marruar me datën:	
Emri i personit/organizatës qe e ka marruar mostrën	
Metoda e mostrimit	
Data dhe ora e aritjes se mostrës ne laborator	
Data e refuzimit se mostrës	
Lloji i mostrës	Sasia

Arsyeja e refuzimit të mostrës:	1. Mungojnë të dhënat e mjaftueshme për mostër
	2. Mostra e dëmtuar dhe e papërshtatshme për analiza
	3. Nuk janë mënjanuar arsyet e vendosjes se mostrës "ne pritje" dhe ka skaduar afati brenda se çiles mostra është e përshtatshme për analize
	4. Te tjera:
Emri i personit qe e ka kontrolluar dhe refuzuar mostrën:	
Nënshkrimi i personit përgjegjës:	
Data:	

3. URDHERI I ANALIZAVE LABORATORIKE LVUK / M-3

TE DHENAT MBI MOSTREN			
Numri Identifikues i mostrës (Nr. ID_M)			
Data e pranimit te mostrës			
Origjina e mostrës			
Mostra	Lloji:		
	Sasia:		
	Temperatura:	°C	Korrigjimi: - 0,06 °C
Shenja e laboratorit ne te cilin mostra dërgohet /përcillet			
Data dhe ora kur mostra i është dorëzuar laboratorit			
Nënshkrimi i personit qe ka pranuar mostrën			
Gjate pranimit paketimi i mostrës ka qene:			
komplet	jo komplet		
ne përputhje	jo ne përputhje me specifikat e fletedergeses		
ANALIZAT TE CILAT KERKOHEN:			
1	4	7	
2	5	8	
3	6	9	
TË DHENAT NGA LABORATORI			
Data kur kane filluar kërkimet:		Data kur kane përfunduar kërkimet:	
Përshkrimi i metodave te cilat janë përdorur	1	5	
	2	6	
	3	7	
	4	8	
Shënime:			
Nënshkrimi i analizuesit:			

4. LISTA E PRITJES (MOSTRAT ME MANGESI) LVUK / M-4

TE DHENAT E KLIENTIT			
Nr. Identifikues i mostrës (IDM)			
Emri i klientit, organizata			
Adresa/Rruga			
Vendi/Fshati dhe nr. postal			
Regjioni			
Nr. i licencës			
Telefon:	Telefaks:	E-mail:	
Të dhënat për mostrën			
Data dhe ora e pranimit të mostrës ne			
Origjina e mostrës:			
Lloji i mostrës:	Sasia:		
Emri i personit qe e kontrolloi mostrën dhe dokumentin përcjellës:			
Arsyeja e vendosjes se mostrës ne "listën e pritjes"	1. Dokumentet e pamjaftueshme përcjellëse		
	2. Te tjera		
VENDI I RUAJTJES SE MOSTRES NE LISTEN E PRITJES			
Laborator	Frigorifer	Frigo	Temp. e dhomës
SHENIME:			
DATA E MENJANIMIT TE MANGESIVE:			
Emri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës:			

5. TE MOSTRUARIT LVUK / M-5

TE DHENAT E KLIENTIT	
Emri i klientit, organizata	
Adresa/Rruga	
Vendi/Fshati dhe nr. postal	
Regjioni	
Nr. i licencës	
Telefoni	
Telefax	
E-mail	
TE DHENAT PER MOSTRIMIN	
Data dhe ora e marrjes se mostrës	
Emri dhe titulli i personi qe merr mostrën	
Vendi (adresa) e marrjes se mostrës	
Metoda e mostrimit	
Të dhënat për mostrën	
Lloji i mostrës	
Sasia	
Temperatura e ambientit gjate mostrimit (nëse është e nevojshme)	
Temperatura e mostrës gjate marrjes (nëse e nevojshme)	
Shënime	

Nënshkrimi i personit qe e ka kryer mostrimin

6. PERCJELLJA E MOSTRAVE NE INSTITUCION / LABORATOR TJETER LVUK / M-6

TE DHENAT MBI MOSTREN		
Nr. ID_M		
Porositësi:		
Pronari:		
Nr. l udhëzimit/shkresës:		
Data/ora e pranimit te mostres ne laborator		
Përshkrimi i mostrës:		
Sasia		
Analiza te cilat kërkohen		
Shkresa e dërguesit mbahet:	PO	JO
Dërgesa gjate pranimit:	Hapur	Mbyllur
Emri i institucionit/labororit ne te cilin dërgohet:		
Data/ora e dërgesës ne institucionin/laboratorin tjetër		
Shpenzimet i mbulon:	Porositësi	
	Pronari	
	Laboratori	
	MBPZHR, AVUK, urdhëresa, monitorimi...	
	Te tjera	
Shënime:		
Udhëheqësi i Labororit		Drejtori:
.....		

7. FORMA E PERGJITHSHME –GJENERALE LVUK / M-7

TE DHENA MBI KLIENTIN		
Emri dhe mbiemri i klientit/organizata		
Adresa/Rruga		
Vendi/Fshati dhe nr. postal		
Regjioni		
Nr. i licencës		
Telefoni		
Telefax		
E-mail		
TE DHENA MBI MOSTREN		
Data e dorëzimit të mostrës:		
Lloji i mostrës:		
Paketimi:		
Sasia:		
Nënshkrimi i klientit:		Nënshkrimi i personit që ka pranuar mostrën: